



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 33959/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Emilia Redjepi nga Prizreni, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 18.04.2011 merrë këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA :Emilia Redjepi , e lindur më 1973 në Prizren , me profesion Zv. Ministre në Ministrinë e Energjis dhe Minierave , e gjendjes së mirë ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

E pandehura në cilësinë e zëvendës ministres në Ministrinë e Energjis dhe Minierave , ku ka qenë e obliguar me ligjë në afatin ligjor për deklarimin e pasurisë për vitin 2010 të paraparë me ligjë, të Agjencionit Kundër Korrupsionit ,ku e njëjta nuk e ka deklaruar pasurinë e vetë .

Me këtë të ka kryer vepër kundërvajtëse nga **16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 300(treqind) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirollogarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtoi kërkesën nr.01/3495/10 të dt .26.10.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehures së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës e pandehura u dëgjua në deklaraten e saj ku deklaroi se më datën 7 Qershor 2010 kam punuar si Zëvendës Ministri Ministrinë e Energjis dhe Minierave dhe prej kësaj kohe jam në këtë detyrë ku pas 15 ditësh kam pranuar kuvertën e cila ka qenë e Agjencionit kundër Korrupsionit për deklarimin e pasurisë unë e kam mbushur këtë formular dhe e kemi dorëzuar te Sekretari I Ministris gjegjësisht te ushtruesi i detyrës Hakif Jashari. Unë nuk e kam ditur se a duhet të dorëzohet personalisht ky formular apo përmes sekretit të kësaj Ministrie dhe unë kam menduar se ky formular është dorëzuar në Agjencionin Kundër Korrupsionit, ku e njëjta ka thënë se do të sjelli provat po deri më tash nuk i ka sjellur, ku dhe i është dhënë afati prej dy ditësh të cilën e ka kërkuar vetë.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje me të drejt konstatoj se pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila i v në barrë tërësi vërtetoi , andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe së në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të kësaj lloji dhe të ngjashme. ,andaj u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Edmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.